REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.3408 Prot

Maliq, më 01.06.2026

VENDIM
Nr. 60 datë 29.05.2026

"Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 29.05.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 3, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 66, pika 11 e Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 29.05.2026 me ndryshimet e propozuara dhe njoftimit bashkangjitur.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3037/2 Prot. Maliq, më 21.05.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte, **më datë 29.05.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (30.04.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V"Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.S.K banues në Fshatin Vloçisht Nj.A Libonik, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 *"Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
8.P-V "Miratimin e shpërblimit me honorar për anagazhimin e një koreografi për ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Mulltifunksionale *"Dhimitër Orgocka"*, Maliq";
9.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.146, datë 24.12.2025, *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026";*
10.P-V "Për miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026";
11.P-V "Për miratimin e programit të transparencës të Bashkisë Maliq";
12.P-V "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve nga programi i subvencionit të qirasë";
13.P-V"Për miratimin në parim për dhënien në përdroim të fondit pyjor, për ndërtimin e Kullave Eolike nga Kompania *"WP MORAVA"* shpk.";
14.P-V "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.19 datë 30.01.2026, *"Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi t ë Bashkisë Maliq";*
15.Prezantimi i Raportit të Performancës për Bashkinë Maliq viti 2025.

16.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e enjte me datë 28.05.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5 të rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 7, 8, 9, 10, 13, 14 të rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.
Pika 6 e rendit të ditës: z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Faslli Zholi, z.Yllson Ibrahimllari

Komisioni Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pika 11 e rendit të ditës: znj.Pranvera Begolli, z.Petrit Kupe, z.Kristina Malelli, z.Yllson Ibrahimllari, znj.Eglantina Balli.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 12 e rendit të ditës: z.Idlir Limllari, znj.Pranavera Begolli, z.Selami Muço, z.Faslli Zholi, Almir Elezi.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ